

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-160/13**

**Prishtinë,  
5 mars 2014**

Në çështjen juridike të

**S. D.**  
D. 17 16  
Z. Z.  
S.

***Paraqitësja e kërkesës/Pala ankuese***

kundër.

**Nuk dihet**

***Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/193/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13927), të datës 13 shkurt 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 5 mars 2014, mori këtë:

## JUDGMENT

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/193/2013, të datës 13 shkurt 2013.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/193/2013, i datës 13 shkurt 2013, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA13927.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 6 nëntor 2006, S. D. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës ku ka kërkuar konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit dhe ri-posedimin e pronës-objektit afarist. Ajo pohon se asaj i ishte lejuar që të ndërtojë objektin afarist në ngastrën nr. 7074, zona kadastrale e Prizrenit, Komuna e Prizrenit. Objekti afarist ka një sipërfaqe prej 35 m<sup>2</sup>.
2. Objekti afarist ndodhet në Prizren, rruga "Metohijska", në vendin e quajtur Stacioni i Trenit, ngastra nr. 15. Ajo ka deklaruar se prona e kërkuar ishte uzurpuar nga R. K. nga M., Komuna e Prizrenit. Ajo e kishte humbur posedimin e këtij objekti afarist për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur që ndodhi në Kosovë në vitet 1998/1999, duke cekur 12 qershorin 1999 si datë të humbjes.
3. Për të mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur një kopje të Vendimit nr. 04/4-351-195, të lëshuar më 1 tetor 1992 nga Komuna e Prizrenit. Kjo kopje e vendimit vërteton se paraqitëses së kërkesës i ishte dhënë një lokacion për ngritjen e një objekti të përkohshëm në një pjesë të ngastrës kadastrale nr. 7074, zona kadastrale e Prizrenit, rruga "Metohijska", në vendin e quajtur Stacioni i Trenit, ngastra e tokës nr. 15, me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve (nuk specifikohet) dhe në kohëzgjatje prej 10 viteve, nga data e marrje së vendimit.
4. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA13927.
5. Më 26 mars 2007, zyrtarët e AKP-së shkuan në vendin kur ndodhej prona e kërkuar dhe kanë gjetur se objekti ishte uzurpuar nga F. M., i cili nuk ka kërkuar të drejtën ligjor ndaj pronës së kërkuar dhe ka nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje. Në vitin 2010, AKP-ja përsëri ka nxjerrë një informacion lidhur me kërkesën, kësaj here duke e publikuar kërkesën në Gazetën e Njoftimeve nr. 3 dhe në Buletinin e Zyrës për Çështje Pronësore të UNHCR-së. Letra dhe lista janë lënë në të gjitha komunat dhe Gjykatat Komunale të Regjionit dhe në Drejtoratin për Kadastër në Prizren. Kopjet e të njëjtave po ashtu janë lënë edhe në Zyrat Regjionale të UNHCR-së, Avokatit të Popullit, ZCN-së dhe CPRK-së.

6. Sipas raportit të verifikimit të datës 15 tetor 2007, vendimi i lartcekur nr. 04/4-351-195, i lëshuar më 1 tetor 1992 nga Komuna e Prizrenit, ishte verifikuar pozitivisht nga ekipi për verifikim i AKP-së. Derisa po e kërkonte ngastrën nr. 7074, AKP-ja ka gjetur vetëm ngastrën nr. 7074/3, e cila sipas Certifikatës së të Drejtave të Paluajtshme Pronësore nr. P-71813068-07074-3, e lëshuar më 31 maj 2011 nga Drejtorati për Kadastër, Komuna e Prizreni, është pronë shoqërore.
7. Më 13 shkurt 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), me vendimin e tij KPPC/D/C/193/2013, e ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit. Në arsyetimin e vendimit të tij, KKPK-ja thekson se sipas provave, paraqitësja e kërkesës kishte të drejtën e shfrytëzimit të përkohshëm ndaj pronës së kërkuar, prandaj ajo ka qenë e autorizuar që vetëm të ndërtojë një strukturë të luajtshme në pronë e kërkuar.
8. Prandaj, prona e kërkuar duhet të konsiderohet si send i luajtshëm sipas nenit 9 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (Ligji nr. 03/L-154). Në anën tjetër, në pajtim me paragrafin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KKPK-ja nuk ka juridiksion që të vendos për pronat e luajtshme.
9. Më 21 maj 2013, vendimi i ishte dorëzuar Svetlana Domazetović dhe ajo ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme më 20 qershor 2013 (këtej e tutje: pala ankuese).
10. Pala ankuese ka sqaruar se e kishte ndërtuar objektin afarist me material të fortë si ndërtesë e përhershme e ngjitur për toke, në bazë të Vendimit nr. 01-011-84, të lëshuar më 8 dhjetor 1992 nga Komuna e Prizrenit, me anë të së cilit asaj i ishte ndarë toka për 10 vite dhe Vendimit nr. 04/4-351-195, të lëshur më 1 tetor 1993 nga Drejtorati për Urbanizëm, Shërbime Komunale dhe Strehim dhe Ndërtimtari, me anë të së cilit asaj i ishte dhënë lokacioni për ngritjen e objektit afarist.
11. Prandaj, vendimi i KKPK-së bazohet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve dhe Komisioni nuk ka arritur të vërtetojë se objekti i ndërtuar ishte pronë e paluajtshme e jo pronë e luajtshme. Vendimi i kundërshtuar po ashtu mbështetet në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që të marrë vendim me të cilin do të vërtetohej se ajo ka të drejtën e ri-posedimit të objektit të lartpërmendur afarist.

**Arsyetim ligjor:**

12. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve të paraparë me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).
13. Pas shqyrtimit të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, Gjykata Supreme gjeti se ankesë është e pabazuar.

14. KKPK-ja i ka vlerësuar drejtë provat kur ka vendosur se kërkesa është jashtë fushëveprimit të juridiksionit të KKPK-së. KKPK-ja dhënë sqarime dhe shpjegime të plota, gjithëpërfshirëse, të qarta, të sakta dhe rrjedhimisht ligjore rreth fakteve qenësore për një vendim të drejtë.
15. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Në kuptim të kësaj dispozite, rrjedh se juridiksioni i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës e në këtë mënyrë edhe i Gjykatës Supreme, është i kufizuar ekskluzivisht në zgjidhje, gjykim dhe vendosje të kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën e paluajtshme bujqësore dhe atë komerciale.
16. Nuk është e kontestueshme se sipas Vendimit nr. 04/4-351-195, të leshur më 1 tetor 1993 nga Drejtorati për Urbanizëm, Shërbime Komunale dhe Strehim dhe Ndërtimtari e Komunës së Prizrenit, është vërtetuar se paraqitëses së kërkesës i ishte dhënë lokacioni për ngritjen e një objekti banesor në ngastrën kadastrale nr. 7074, në rrugën “Metohijska”, në vendin e quajtur Stacioni i Trenit, ngastra nr. 15. Leja ishte dhënë për vendosje të përkohshme të objektit në ngastrë, i cili është konsideruar si objekti i luajtshëm.
17. Gjykata Supreme po ashtu konsideron se prona e kërkuar sipas nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (Ligji nr. 03/L-154) është një send i luajtshëm. Sipas kësaj dispozite ligjore rezulton se ndërtesat, kiosqet e përkohshme montazh dhe strukturat e përkohshme montazh, siç është rasti konkret, nuk konsiderohen sende të paluajtshme. Për më tepër, neni 14 par. 1 dhe neni 26 par. 2 të Ligjit për Tokën Ndërtimore (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 14/80) parashikon se kur organi kompetent e jep në shfrytëzim të përkohshëm për nevojat e përkohshme kërkuar për vendosjen objekteve të përkohshme të tipit montazh, atëherë ai organi ka të drejtë që sipas nevojave të planit urbanistik ta dislokoj atë objekt me shpenzimet personale të shfrytëzuesit. Madje, objekti i përkohshëm nuk mund të jetë çështje e pranimit të drejtës së pronës e as që mund të regjistrohet në regjistrin e pronësisë së zyrës për kadastrë.
18. Prandaj, vendimi ankimor nuk përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale. Po kështu, ky vendim nuk bazohet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, siç pretendon pala ankuese
19. Ky aktgjykim nuk përjashton dhe kufizon të drejtën e paraqitësi të kërkesës për t'i kërkuar të drejtat e tij në gjykatat kompetente.

**Këshillë ligjore:**

20. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

*Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX*

*Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it*

*Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Urs Nufer, Referent i EULEX-it*